



Funded by  
the European Union



MODELI KOLEGIAL I SIGURIMIT TË CILËSISË NË KOSOVË

SHEMBULLI B

# RAPORTI MBI SIGURIMIN E CILËSISË NË KOMUNË

Projekti "Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë"



Rasti kur: *Shkolla ka nevojë për përmirësim të konsiderueshëm*

<b>Emri i shkollës</b>	
<b>Data e vlerësimit</b>	<b>1 - 5 tetor 2022</b>
<b>Komuna</b>	

# 1. MENAXHIMI DHE QEVERISJA

1.1 Organet qeverisëse punojnë në mënyrë efektive për t'i përfaqësuar interesat e komunitetit të shkollës

<b>Treguesit e performancës së shkollës me shembuj</b>
Pikëpamjet e prindërve, stafit të shkollës dhe nxënësve merren parasysh në procesin e vendimmarrjes së shkollës.
<b>Komentet me dëshmi</b>
Ekziston këshilli i shkollës. Megjithatë, bisedat me stafin, nxënësit, prindërit dhe dëshmitë nga pyetëtorët tregojnë se këshilli i shkollës nuk ka një rol të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes së shkollës. Stafi dhe nxënësit treguan se nuk kishte mekanizma që nxënësit t'i shprehnin pikëpamjet e tyre dhe të ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënimit në shkollë.
<b>Lëvdatat</b>
Nuk ka
<b>Rekomandimet</b>
Drejtoria e shkollës duhet t'i hulumtojë mënyrat që t'u jep nxënësve më shumë mundësi për të diskutuar lidhur me cilësinë e mësimdhënies që ata e marrin dhe për t'i ndarë këto mendime me mësimdhënësit.

## 1.2 Të dhënat e vlerësimit të nxënësve analizohen nga drejtoria e shkollës dhe ata informojnë mbi vendimmarrjen

<b>Treguesit e performancës së shkollës me shembuj</b>
Arritjet e nxënësve maten në mënyrë efektive, analizohen dhe informojnë planifikimin e shkollës.
<b>Komentet me dëshmi</b>
Drejtoria dhe stafi i shkollës takohen për t'i analizuar dëshmitë e vlerësimit. Megjithatë, të dhënat e vlerësimit bazohen më shumë në mendimet e mësuesve sesa në dëshmi të qarta. Të dhënat e vlerësimit nuk krahasohen me forma tjera të dhënave siç janë anketat e nxënësve. Ekipi vizitues ka vërejtur se mësuesit nuk i përdorin rubrikat për të përcaktuar qëllime të qarta për nxënësit. Kur u pyetën, nxënësit nuk i kishin të qartë hapat e tyre të ardhshëm në nxënie. Ata marrin nota nga mësuesit (1,2,3,4,5) por jo gjithmonë e dinin pse i morën ato nota.
<b>Lëvdatat</b>
Asnjë
<b>Rekomandimet</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Mësuesit duhet të përpiqen që t'i përdorin rubrikat më shumë për ta evidentuar më mirë vlerësimin e tyre dhe për të përcaktuar qëllime të qarta për nxënësit.</li><li>• Të dhënat e vlerësimit duhet, po ashtu, të krahasohen me anketat e nxënësve për sa i përket qëndrimin e tyre ndaj të nxënit.</li></ul>

### 1.3 Drejtoria e shkollës e zbaton në mënyrë efektive kurrikulën duke përdorur praktika të dëshmuara pedagogjike.

<b>Treguesit e performancës së shkollës me shembuj</b>
Niveli i mesëm menaxhues i shkollës siguron që planifikimi të jetë efektiv dhe i drejtuar nga praktikat e dëshmuara pedagogjike.
<b>Komentet me dëshmi</b>
<p>Edhe pse të gjithë mësime të prodhojnë plane mësimore ditore dhe javore, ato përmbajnë pak dëshmi të praktikave të dëshmuara pedagogjike. Nuk kishte dëshmi të strategjive të mësime të përgjegjshme (vlerësimi diagnostik i njësive mësimore/vlerësim formativ), nuk kishte dëshmi të nxënësve të vetërregulluar në planifikim (nxënësve nuk bënin vetë-vlerësim të punës së tyre dhe nuk i përcaktonin qëllimet për vetveten). Nuk kishte dëshmi të praktikave efektive të dhënies së informatave kthyes në dokumentacionin e planifikimit. Nuk kishte asnjë dëshmi se mësimi ishte i individualizuar për t'i përmbushur nevojat e të gjithë nxënësve. Drejtoria e shkollës nuk ishte në dijeni të cilësisë së praktikës pedagogjike sepse ishte realizuar pak vëzhgime gjatë mësimeve. Drejtori i shkollës ishte i vetmi anëtar i stafit që i vëzhgonte orët mësimore. Shumica e mësimeve të intervistuar thanë se zakonisht nuk merrnin informata kthyes konstruktive për ta përmirësuar praktikën e tyre profesionale.</p>
<b>Lëvdatat</b>
Drejtoria e shkollës për krijimin e një kulture vëzhguese mbështetëse.
<b>Rekomandimet</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Drejtoria të krijojë një politikë mbështetëse me dyer të hapura për vëzhgimin e orëve mësimore, në mënyrë që një numër më i madh i stafit t'i vëzhgojë orët mësimore dhe të japë informata kthyes mbështetëse.</li><li>• Shkolla përdor ditët e zhvillimit profesional të mësimeve me bazë në shkollë për t'u fokusuar në përmirësimin pedagogjik që e individualizon të nxënësve për nxënësve.</li></ul>

#### 1.4 Zhvillimi i shkollës i jep përparësi nevojave të nxënësve.

<b>Treguesit e performancës së shkollës me shembuj</b>
Shkolla bënë vetë-vlerësime efektive të shkollës që çojnë në përmirësimin e rezultateve të nxënësve.
<b>Komentet me dëshmi</b>
Shkolla sapo ka filluar ta përdorë vetë-vlerësimin në mënyrë më efektive. Ekipi i vetë-vlerësimit i ka ndjekur udhëzimet dhe ka vëzhguar një numër të madh të orëve mësimore për të prodhuar një vetë-vlerësim të saktë të shkollës. Shkolla përdor pyetësorë, por ata nuk janë në format digjitalë dhe kërkojnë kohë për t'u analizuar.
<b>Lëvdatat</b>
Ekipi i vetë-vlerësimit të shkollës për realizimin e një vetë-vlerësimi të qartë dhe të saktë.
<b>Rekomandimet</b>
Shkolla i përdorë anketat online për të mbledhur të dhëna në mënyrë më të rregullt dhe më efikase.

1.5 Prioritetet e zhvillimit të shkollës monitorohen dhe analizohen në mënyrë efektive.

Treguesit e performancës së shkollës me shembuj
Zbatimi i suksesshëm i planit zhvillimor të shkollës monitorohet dhe analizohet nga drejtorja e shkollës dhe këshilli i shkollës.
Komentet me dëshmi
Drejtorja e shkollës e përgatit planin zhvillimor të shkollës për çdo vit. Bisedat treguan se në vitet e mëparshme zhvillimi pedagogjik nuk ishte identifikuar. Bisedat me këshillin e nxënësve treguan se nxënësit nuk kanë mundësi ta diskutojnë pedagogjinë me stafin e mësimdhënësve.
Lëvdatat
Asnjë
Rekomandimet
Të zhvillohen mekanizma të duhur për moshën e nxënësve që ata të flasin lidhur me mësimdhënien dhe nxënien, dhe t'i ndajnë këto pikëpamje me stafin mësimdhënës. (Për shembull: takime të rregullta me nxënësit për ta diskutuar cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënit në çdo lëndë).



## 2. KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR

2.1 Objekti shkollor dhe hapësirat tjera janë të qasshme, të sigurta, të shëndetshme dhe miqësore

Treguesit e performancës së shkollës me shembuj

- Mjedisi fizik i shkollës është i sigurt dhe i favorshëm për zhvillimin e fëmijëve. *\*Vetëm inspektorët e certifikuar të shkollës dhe zyrtarët e sigurisë mund ta bëjnë këtë vlerësim zyrtarisht.*
- Higjiena, në të gjitha hapësirat e shkollës është në nivel të lartë. *\*Vetëm inspektorët e certifikuar të shkollës dhe zyrtarët e sigurisë mund ta bëjnë këtë vlerësim zyrtarisht.*
- Shkolla është mbështetëse dhe miqësore.
- Të gjithë nxënësit, prindërit dhe stafi i shkollës trajtohen me dinjitet dhe respekt.

Komentet me dëshmi

Nuk është vërejtur asnjë rrezik i qartë fizik nga ekipi vizitues. Nxënësit ishin miqësorë dhe të respektueshëm, por bisedat me nxënësit dhe stafin treguan se nxënësit nuk pyeteshin shpesh për përvojat e tyre të të nxënit në shkollë.

Lëvdatat

Asnjë

Rekomandimet

Të zhvillohen mekanizma që nxënësit të flasin për përvojat e tyre në shkollë, duke përfshirë mësimdhënien dhe të nxënit. Të sigurohet ndarja e pikëpamjeve konfidenciale të nxënësve me stafin mësimdhënës.

## 2.2 Shkolla është gjithëpërfshirëse dhe i merr parasysh nevojat individuale të nxënësve.

### Treguesit e performancës së shkollës me shembuj

- Shkolla u mundëson të gjithë nxënësve të kenë qasje në kurrikulën për nevoja specifike mësimore, duke përfshirë nxënësit me prirje dhe të talentuar, dhe të kenë mundësi për sukses në mësimet e tyre, në raport me aftësitë e tyre.
- Shkolla punon në mënyrë efektive me agjenci të jashtme për të siguruar që të gjithë fëmijët të kenë qasje të barabartë në një arsim të cilësisë së lartë.

### Komentet me dëshmi

Dëshmitë nga vëzhgimet e orëve mësimore tregojnë se nevojat individuale të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore nuk adresohen. Shumica e orëve mësimore të vëzhguara ishin të njëtrajtshme. Ligjëratat e udhëhequra nga mësimdhënësit u ndoqën nga të gjithë nxënësit të cilët e kryenin të njëjtën detyrë në të njëjtën kohë dhe të njëjtin ritëm. Nuk kishte dëshmi të vlerësimeve diagnostikuese gjatë orës së mësimit për të vlerësuar nëse nxënësit e kuptojnë detyrën.

Shumica e mësimdhënësve nuk bëjnë asnjë përpjekje për t'i përshtatur tekstet shkollore për t'i përmbushur nevojat individuale të nxënësve. Kishte fare pak dëshmi që nxënësve të talentuar t'u jepen detyra sfiduese në orët mësimore. Ishte po ashtu e qartë nga bisedat me nxënësit dhe vëzhgimet e orëve të mësimit se shumë nxënës me nevoja të veçanta arsimore shpesh nuk ishin në gjendje t'i qaseshin kurrikulës.

### Lëvdatat

Mësimdhënësit për përpjekjet që ta individualizojnë të nxënësit nëpërmjet përdorimit të një varg strategjive.

### Rekomandimet

- Ditët e zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë përdoren për ta trajnuar stafin në strategjitë e mësimdhënies së përgjegjshme, strategjitë e të nxënësit të vetërregulluar, strategjitë e dhënies së informatave kthyesë efektive dhe individualizimin e të nxënësit për t'i përmbushur nevojat individuale të nxënësve.
- Drejtoria e shkollës e aplikon një kulturë mbështetëse me dyer të hapura të vëzhgimit të orëve të mësimit, në mënyrë që stafi të vëzhgohet shpesh dhe udhëzohet se si ta individualizojnë të nxënësit në mënyrë efektive.

## 2.3 Gama dhe përshtatshmëria e burimeve për mësimdhënie dhe nxënie efektive

<b>Treguesit e performancës së shkollës me shembuj</b>
Burimet janë të mjaftueshme për t'i përmbushur kërkesat e kurrikulës bërthamë.
<b>Komentet me dëshmi</b>
<p>Shkolla posedon një varg burimesh duke përfshirë një kabinet të pajisur mirë të TIK-ut, sallë sportive, bibliotekë të vogël. Burimet janë të mjaftueshme për t'i përmbushur kërkesat e kurrikulës bërthamë. Megjithatë, shkolla nuk ka një laborator të shkencave të pajisur mirë. Po ashtu, është e qartë që tekstet shkollore të disa lëndëve nuk i plotësojnë kërkesat e kurrikulës.</p> <p>Mësimdhënësit nuk e përdorin laboratorin e TIK-ut sepse nuk kanë ndjekur ndonjë trajnim. Edhe pse tekstet shkollore nuk i plotësojnë kërkesat e kurrikulës, shumica e mësimdhënësve nuk bëjnë fare përpjekje për t'i përshtatur tekstet shkollore për t'i përmbushur më mirë kërkesat e kurrikulës dhe për t'i plotësuar nevojat individuale të nxënësve. Nxënësit thanë se nuk u ofrohej shpesh material plotësues dhe rrallëherë udhëzoheshin t'i shfrytëzojnë burimet online për ta përmirësuar kurrikulën.</p>
<b>Lëvdatat</b>
Asnjë
<b>Rekomandimet</b>
Drejtoria e shkollës organizon ditët e trajnimit me bazë në shkollë për mësimdhënësit që t'i mbledhin dhe analizojnë materiale mësimore nga interneti të cilat mund të përdoren për t'i përmbushur kërkesat e kurrikulës.

## 2.4 Përfshirja e komunitetit të shkollës në mirëmbajtjen e mjedisit fizik

<b>Treguesit e performancës së shkollës me shembuj</b>
Prindërit, nxënësit dhe stafi janë të përfshirë në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit të shkollës.
<b>Komentet me dëshmi</b>
Bisedat me këshillin e shkollës tregojnë se ata zakonisht nuk përfshihen në përmirësimin e mjedisit shkollor. Prindërve nuk u mundësohet të japin kontribut financiar shtesë për shkollën. Këshilli i nxënësve ishte i interesuar për ta përmirësuar mjedisin shkollor, por nuk ishin të sigurt se si mund ta bënin këtë.
<b>Lëvdatat</b>
Asnjë
<b>Rekomandimet</b>
Këshillit të nxënësve t'i jepet më shumë liri që ta përmirësojë mjedisin e shkollës.

# 3. MËSIMDHËNIA, TË NXËNIT DHE VLERËSIMI

## 3.1 Strategjitë e mësimdhënies dhe vlerësimit

### Treguesit e performancës së shkollës me shembuj

- Mësimdhënësit përdorin një varg strategjish të mësimdhënies dhe të të nxënit të dëshmuara në aspektin pedagogjik.
- Mësimdhënësit përdorin një varg strategjish të vlerësimit të dëshmuara në aspektin pedagogjik dhe e përshtatin nxënien për t'i përmbushur nevojat individuale të nxënësve.

### Komentet me dëshmi

Ekipi vizitues i vëzhgoi disa shembuj të praktikave të dëshmuara pedagogjike siç janë strategjitë e mësimdhënies së përgjegjshme (vlerësimi diagnostikues në orë të mësimi) dhe të mësuarit e vetërregulluar. Në dokumentacionin e planifikimit dhe orët e vëzhguara të mësimi kishte pak dëshmi që të nxënit ishte individualizuar për t'i përmbushur nevojat e të gjithë nxënësve.

Shumica e orëve mësimore të vëzhguara ishin të njëtrajtshme. Zakonisht mësimdhënësi u ligjëronte nxënësve përpara se t'ua jepte të gjithë klasës të njëjtën detyrë nga teksti shkollor. Nuk kishte dëshmi të vlerësimeve diagnostikuese gjatë orës së mësimi për të vlerësuar nëse nxënësit e kuptojnë detyrën. Mësimdhënësit zakonisht bënë 'pyetje të mbyllura' në të cilat përgjigjeshin të njëjtët nxënës. Shumica e mësimdhënësve nuk bëjnë asnjë përpjekje për t'i përshtatur tekstet shkollore për t'i përmbushur nevojat individuale të nxënësve. Kishte fare pak dëshmi që nxënësve të talentuar t'u jepen detyra sfiduese në orët mësimore. Si rezultat, niveli i angazhimit të nxënësve në shumicën e orëve mësimore ishte jashtëzakonisht i ulët.

Ekipi vizitues i ka vëzhguar një numër të vogël të mësimdhënësve të cilët përdornin një numër më të madh të strategjive për ta individualizuar të nxënit dhe për t'i angazhuar nxënësit, por këto orë mësimi ishin të pakta.

### Lëvdatat

Asnjë

### Rekomandimet

Drejtoria të krijojë një politikë mbështetëse me dyer të hapura për vëzhgimin e orëve mësimore, në mënyrë që një numër më i madh i stafit t'i vëzhgojë orët mësimore dhe të japë informata kthyesë mbështetëse. Shkolla përdor ditët e zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë për t'u fokusuar në përmirësimin pedagogjik që e individualizon të nxënit për nxënësit.

### 3.2 Individualizimi i të nxënit për t'i plotësuar nevojat e nxënësve.

#### Treguesit e performancës së shkollës me shembuj

- Mësimdhënia është mbështetje e individualizuar për të cilën nxënësit kanë nevojë.
- Mësimdhënësit përdorin strategji të vlerësimit për ta përshtatur nxënien që t'i plotësojë nevojat individuale të nxënësve.

#### Komentet me dëshmi

Ekipi vizitues ka vërejtur pak dëshmi se të nxënit në shumicën e klasave ishte individualizuar në mënyrë efektive për të përmbushur nevojat e të gjithë nxënësve. Shumica e orëve mësimore të vëzhguara ishin të njëtrajtshme. Zakonisht mësimdhënësi u ligjëronte nxënësve përpara se t'ua jepte të gjithë klasës të njëjtën detyrë nga teksti shkollor. Nuk kishte dëshmi të vlerësimeve diagnostikuese gjatë orës së mësimit për të vlerësuar nëse nxënësit e kuptojnë detyrën. Mësimdhënësit zakonisht bënë 'pyetje të mbyllura' në të cilat përgjigjeshin të njëjtët nxënës. Shumica e mësimdhënësve nuk bëjnë asnjë përpjekje për t'i përshtatur tekstet shkollore për t'i përmbushur nevojat individuale të nxënësve. Kishte fare pak dëshmi që nxënësve të talentuar t'u jepen detyra sfiduese në orët mësimore. Si rezultat, niveli i angazhimit të nxënësve në shumicën e orëve mësimore ishte jashtëzakonisht i ulët.

#### Lëvdatat

Asnjë

#### Rekomandimet

- Drejtoria të krijojë një politikë mbështetëse me dyer të hapura për vëzhgimin e orëve mësimore, në mënyrë që një numër më i madh i stafit t'i vëzhgojë orët mësimore dhe të japë informata kthyesë mbështetëse.
- Shkolla përdor ditët e zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë për t'u fokusuar në përmirësimin pedagogjik që e individualizon të nxënit për nxënësit. (veçanërisht për sa i përket përshtatjes së teksteve shkollore).

### 3.3 Përfshirja e nxënësve në procesin mësimor

Treguesit e performancës së shkollës me shembuj
<ul style="list-style-type: none"><li>• Nxënësit mësohen të zhvillojnë shkathtësi të pavarura të të nxënit nëpërmjet vetë-vlerësimit sistematik dhe vendosjes së caqeve.</li><li>• Nxënësit janë të vetë-motivuar dhe demonstrojnë aftësinë për të menduar vetë.</li></ul>
Komentet me dëshmi
Bisedat me nxënësit, analiza e dokumentacionit të planifikimit dhe puna e nxënësve treguan shumë pak dëshmi të vetë-vlerësimit të nxënësve. Mësimdhënësit rrallë përdorin rubrika.
Lëvdatat
Asnjë
Rekomandimet
Stafi trajnohet për praktikat efektive të informatave kthyese.

### 3.4 Informatat kthyese dhe notimi

<b>Treguesit e performancës së shkollës me shembuj</b>
Informatat kthyese efektive të synuara me shkrim dhe me gojë ndihmojnë në plotësimin e nevojave individuale të studentëve.
<b>Komentet me dëshmi</b>
Rishikimi i punës së nxënësve dhe bisedat me nxënësit tregojnë se shumica e informatave kthyese jepen në formën e notave. Nxënësit e intervistuar ishin në gjendje të ndajnë notat që i kanë marrë, por nuk e dinin se si t'i përmirësonin ato, përveçse nëpërmjet strategjive të përgjithshme si 'duhet të punoj më shumë ose duhet të dëgjoj më shumë në orë të mësimit'. Disa nxënës që merrnin rregullisht notën 5 e konsideronin punën të lehtë, por nuk iu jepeshin detyra më sfiduese për t'i bërë. Vëzhgimet e orëve të mësimit dëshmojnë gjithashtu mungesën e sfidës në orët e mësimit për nxënësit me performancë më të lartë.
<b>Lëvdatat</b>
Asnjë
<b>Rekomandimet</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Stafi mësimdhënës të trajnohen në strategjitë efektive të dhënies së informatave kthyese.</li><li>• Mësimdhënësit i planifikojnë sfidat në çdo njësi mësimore.</li></ul>



### 3.5 Shkolla është vazhdimisht e përkushtuar që t'i përmirësojë praktikën e mësimdhënies dhe të nxënësve

<b>Treguesit e performancës së shkollës me shembuj</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Praktikë formale dhe joformale të sigurimit të cilësisë janë të ngulitura në kulturën e shkollës.</li><li>• Stafit rregullisht e rishikon dhe e përshtat praktikën profesionale bazuar në mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë së shkollës.</li><li>• Shkolla e përdor një mekanizëm efektiv për t'i identifikuar nevojat individuale për aftësimin e mësimdhënësve.</li></ul>
<b>Komentet me dëshmi</b>
Aktualisht, shkolla nuk ka ditë të aftësimit gjatë shërbimit të mësimdhënësve në shkollë, por planifikon të ketë 5 ditë aftësimi këtë vit. Bisedat me stafin konfirmuan se në shkollë nuk kishte kulturë të këshillimit të mësimdhënësve, kështu që mësimdhënësit rrallë herë merrnin informata kthyesë mbështetëse dhe konstruktive për cilësinë e mësimdhënies së tyre.
<b>Lëvdatat</b>
Asnjë
<b>Rekomandimet</b>
Drejtoria e shkollës të krijojë një kulturë mbështetëse të dyerve të hapura për vëzhgimin e orëve të mësimi, në mënyrë që një numër më i madh i stafit të mund t'u japë mbështetje konstruktive kolegëve se si ta përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësve.

## 4. ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE NË SHKOLLË

### 4.1 Ofrimi i zhvillimit profesional

Treguesit e performancës së shkollës me shembuj
Shkolla ofron zhvillim profesional të qëndrueshëm dhe të synuar për mësimdhënësit.
Komentet me dëshmi
<p>Mësimdhënësit kanë ndjekur trajnime të shumta nga OJQ-të në dy vitet e fundit, por këto trajnime nuk ishin identifikuar në mënyrë specifike si prioritet nga shkolla. Bisedat me stafin mësimdhënës dhe drejtorin e shkollës treguan se shumë mësimdhënës e konsideronin këtë trajnim si një "ushtrim i plotësimit të katrorit".</p> <p>Bisedat me drejtorin dhe stafin tregojnë se shkolla po planifikon të organizojë punëtori për zhvillimin profesional të mësimdhënësve në shkollë në të ardhmen.</p>
Lëvdatat
Asnjë
Rekomandimet
Asnjë

## 4.2 Monitorimi i zhvillimit profesional

Treguesit e performancës së shkollës me shembuj
Shkolla përdor mekanizma efektivë për ta monitoruar efektivitetin e zhvillimit profesional.
Komentet me dëshmi
Bisedat me nxënësit dhe prindërit tregojnë se nxënësit nuk pyeten rregullisht për praktikën pedagogjike. I vetmi anëtar i stafit të shkollës që i vëzhgon orët e mësimit është drejtori i shkollës.
Lëvdatat
Asnjë
Rekomandimet
<ul style="list-style-type: none"><li>• Përdorni këshillin e nxënësve në mënyrë më proaktive për t'i identifikuar nevojat për trajnime të mësimdhënësve.</li><li>• Drejtorja e shkollës të krijojë një kulturë mbështetëse të dyerve të hapura për vëzhgimin e orëve mësimore për t'i identifikuar më mirë nevojat për trajnime.</li></ul>

## 5. PERFORMANCA E NXËNËSVE

5.1 Nxënësit i ushtrojnë përgjegjësitë e tyre sociale dhe qytetare në klasë, në shkollë dhe në komunitet

Treguesit e performancës së shkollës me shembuj

- Nxënësit ndihen të sigurt, të respektuar, të përmbushur, të përfshirë në jetën shkollore dhe përgjegjës për të kontribuar në klimën pozitive në shkollë.
- Nxënësit janë aktivë dhe vigjilentë në identifikimin e problemeve në klasë, shkollë dhe komunitet dhe kontribuojnë në vendimmarrje.
- Iniciativat e nxënësve theksohen dhe vlerësohen?

Komentet me dëshmi

Nxënësit ishin të sjellshëm dhe të respektueshëm. Strukturat ekzistojnë për të kontribuar në vendimmarrje në shkollë, por studentët e intervistuar nuk besonin se kishin një rol domethënës në vendimmarrje.

Lëvdatat

Asnjë

Rekomandimet

Të forcohet roli i këshillit të nxënësve në mënyrë që ai të ketë më shumë ndikim në mjedisin shkollor dhe cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësve në shkollë.

## 5.2 Të arriturat e nxënësve monitorohen dhe analizohen

<b>Treguesit e performancës së shkollës me shembuj</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Rezultatet e vlerësimit monitorohen dhe vlerësohen me informata kthyesë të qarta në strategjitë e mësimdhënies dhe të të nxënësve.</li><li>• Progresi i nxënësve përcillet në mënyrë sistematike, duke përdorur një numër të dhënash për sa i përket të arriturve për t'i mbështetur nxënësit në maksimizimin e potencialit të tyre.</li></ul>
<b>Komentet me dëshmi</b>
Të analizohen të dhënat e nxënësve në dispozicion. Megjithatë, nxënësve nuk u jepen anketa lidhur me qëndrim ndaj të nxënësve për t'i krahasuar me të dhënat e vlerësimit në mënyrë që t'i identifikojnë më mirë nevojat e nxënësve.
<b>Lëvdatat</b>
Asnjë
<b>Rekomandimet</b>
Drejtorja e shkollës t'i krahasojë të dhënat nga anketat e nxënësve me të dhënat e vlerësimit për t'i ndihmuar në identifikimin e nevojave individuale për trajnime.

### 5.3 Nxënësit janë të angazhuar në aktivitete jashtë kurrikulare

<b>Treguesit e performancës së shkollës me shembuj</b>
Të nxënit përmirësohet përmes përfshirjes në aktivitete brenda dhe jashtë-shkollore.
<b>Komentet me dëshmi</b>
Disa mësimdhënës u ofrojnë nxënësve aktivitete jashtë kurrikulare siç janë klubi i kodimit dhe klubi i thurjes. Në shkollë nuk ka aktivitete jashtë kurrikulare që udhëhiqen nga nxënësit. Nxënësit rrallë herë marrin pjesë në projekte të udhëhequra nga nxënësit dhe ata nuk e përfshijnë komunitetin lokal. Nxënësve u jepet mundësia t'i vizitojnë vendet me bukuri natyrore.
<b>Lëvdatat</b>
Asnjë
<b>Rekomandimet</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Shkolla ta hulumtojë përdorimin e aktiviteteve jashtë kurrikulare që udhëhiqen nga nxënësit.</li><li>• Shkolla të inkurajojë projekte të udhëhequra nga nxënësit ku përfiton komuniteti lokal.</li></ul>

#### 5.4 Nxënësit janë të angazhuar në menaxhimin e progresit të tyre

<b>Treguesit e performancës së shkollës me shembuj</b>
Nxënësit reflektojnë mbi progresin e tyre në mënyrë sistematike dhe mund t'i identifikojnë hapat e tyre të ardhshëm në nxënie.
<b>Komentet me dëshmi</b>
Dëshmitë nga bisedat me stafin dhe nxënësit dhe analiza e librave tregojnë se reflektimi dhe vetë-vlerësimi i nxënësve nuk është pjesë e rëndësishme në kulturën e shkollës. Nxënësit besojnë se nota e tyre është reflektim i asaj se sa mirë dëgjojnë në klasë dhe sa shumë punojnë, por shumë nxënës të intervistuar nuk mbanin mend ndonjë këshillë të caktuar se si t'i përmirësojnë notat e tyre. Mësimdhënësit nuk përdorin rubrika për t'i ndihmuar nxënësit që ta bëjnë vetë-vlerësimin e performancës së tyre.
<b>Lëvdatat</b>
Asnjë
<b>Rekomandimet</b>
Mësimdhënësit të marrin pjesë në zhvillim profesional për përdorimin e praktikave efektive të dhënies së informatave kthyesë.

Ekipi i vetë-vlerësimit të shkollës për realizimin e një vetë-vlerësimi të qartë dhe të saktë.

Drejtoria të krijojë një politikë mbështetëse me dyer të hapura për vëzhgimin e orëve mësimore, në mënyrë që një numër më i madh i stafit t'i vëzhgojë orët mësimore dhe të japë informata kthyese mbështetëse. Shkolla përdor ditët e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve me bazë në shkollë për t'u fokusuar në përmirësimin pedagogjik në fusha të ndryshme që ndihmojnë në individualizimin e të nxënësve për nxënësit. Të zhvillohen mekanizma të duhur për moshën e nxënësve që ata të flasin lidhur me mësimitdhënien dhe nxënien, dhe t'i ndajnë këto pikëpamje me stafin mësimitdhënës. Mësimitdhënësit marrin pjesë në zhvillim profesional për t'i përdorur praktikat efektive të dhënies së informatave kthyese dhe strategjitë e të nxënësve të vetërregulluar.







Kosovo Legal  
Services Company



IBE



EDUCATIONAL  
RESEARCH  
INSTITUTE

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Projektit KosEd dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.